



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 27/4 Prot.

Tiranë, më 17.03.2022

V E N D I M

Nr.42, datë 17.03.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, për vlerësimin e ligjshmërisë të procesit të lirimit nga detyra për shkak të ristrukturimit, të nëpunësit ***, në pozicionin e punës “*Specialist i Nivelit të Lartë*”, në Drejtorinë e Turizmit dhe Promovimit të Vlerave, në Bashkinë Fier.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në neniet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë të procesit administrativ të lirimit nga detyra për shkak ristrukturimi, të nëpunësit *****, me detyrë “*Specialist i Nivelit të Lartë*”, në Drejtorinë e Turizmit dhe Promovimit të Vlerave, në Bashkinë Fier.

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 27, prot., datë 07.01.2022, nëpunësi ***** ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, gjatë procesit administrativ të lirimit nga detyra “*Specialist i Nivelit të Lartë*”, në Drejtorinë e Turizmit dhe Promovimit të Vlerave, në Bashkinë Fier, si pasojë e ristrukturimit të institucionit.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, nëpërmjet postës elektronike të datës 10.02.2022, “*Kërkim*

dokumentacioni në lidhje me lirimin nga detyra, për shkak të ristrukturimit të nëpunësit ***** në pozicionin e punës “Specialist i Nivelit të Lartë”, në Drejtorinë e Turizmit dhe Promovimit të Vlerave, në Bashkinë Fier”, është vënë në dijeni institucioni i Bashkisë Fier, për fillimin e verifikimit të rastit, duke kërkuar njëkohësisht dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Bashkia Fier, me shkresën protokolluar me nr. 27/3 prot., datë 28.01.2021, “Kthim përgjigje”, ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacionin e kërkuar dhe në të njëjtën kohë, në rrugë elektronike në datën 10.02.2022, “Bashkëlidhur, do të gjeni shkresat, në lidhje me punonjësin”, ka dërguar dokumentacionin shtesë që materializon veprimet e kryera në lidhje me procedurën e lirimit të tij nga pozicioni i punës “Specialist i Nivelit të Lartë”, në Drejtorinë e Turizmit dhe Promovimit të Vlerave, në Bashkinë Fier.

Duke shqyrtuar përmbajtjen e akteve të mësipërme, konstatohet se, nëpunësi ***** fillimisht i është drejtuar institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me shkresën protokolluar me nr. 2196 prot., datë 29.12.2021, “Për refuzimin e Bashkisë Fier, për të lëshuar kopje të një materiali bashkëlidhur: Urdhrin e Kryetarit për ristrukturimin e institucionit dhe kopje të dokumentave të mia drejtuar institucionit”, duke pretenduar se njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Fier, padrejtësisht ka refuzuar ti dorëzojë kopje të njësuara me origjinalin të dokumentacionit, pjesë e dosjes të tij, pas lirimit të tij nga detyra.

Në vijim, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të ankesës dhe fakteve të evidentuara në të, ka konstatuar se kjo çështje lidhet me detyrën funksionale të institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe për këtë arsye me shkresën nr. 2196/1 prot., datë 07.01.2022, “Përcillet për kompetencë shqyrtimi, ankesa e ***** Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, e ka dërguar pranë këtij të fundit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor, rezulton se nëpunësi ***** ka qenë i punësuar në Bashkinë Fier prej datës 03.07.2012, dhe me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, është konfirmuar si nëpunës civil për shkak të ligjit (akti deklarimit të statusit të punësimit nr. 1172 prot., datë 09.06.2014 në pozicionin e punës “Specialist i nivelit të lartë”, në Drejtorinë e Përgjithshme, të Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore në Bashkinë Fier).

Në vijim, me urdhrin nr. 631, datë 21.11.2017, të Kryetarit të Bashkisë Fier, pas kryerjes së një ristrukturimi të institucionit, është transferuar në mënyrë të përhershme në pozicionin aktual të punës “Specialist i Nivelit të Lartë”, në Drejtorinë e Turizmit dhe Promovimit të Vlerave, në Bashkinë Fier.

Nëpunësi në fjalë, ka vazhduar të jetë i punësuar në këtë pozicion pune deri kur, me aktin nr. 864, datë 11.11.2021 “Urdhër”, të Kryetarit të Bashkisë Fier, është liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit, pas shprehjes së mospranimit të propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, për kalimin në pozicionin e punës “Inspektor për promovimin e vlerave”, në Drejtorinë e Artit, Kulturës dhe Promovimit të Vlerave, në Bashkinë Fier.

Duke shqyrtuar përmbajtjen e akteve administrative të cilat pasqyrojnë këtë proces administrativ, rezulton se ristrukturimi i institucionit, ka filluar me implementimin e urdhrin nr. 603, datë 12.10.2021, “Për disa ndryshime në Strukturën Organizative të Bashkisë Fier” të Kryetarit të Bashkisë Fier, nëpërmjet të cilit u bënë disa ndryshime në strukturën e mëparshme, të miratuar me urdhrin nr. 266, datë 10.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Fier.

Nga krahasimi i strukturës dhe organikës që ka qenë në fuqi deri në momentin e ristrukturimit (*struktura dhe organika e miratuar me vendimin e këshillit bashkiak nr. 96, datë 02.12.2020, “Për numrin e punonjësve të Bashkisë Fier”*), me strukturën e miratuar me urdhrin nr. 266, datë 10.06.2021, “Për ristrukturimin e strukturës organizative të Bashkisë Fier për vitin 2021”, ndryshuar më pas me urdhrin nr. 603, datë 12.10.2021, të Kryetarit të Bashkisë Fier, vërehet se janë riorganizuar dy drejtori, përkatësisht, “Drejtoria për Përgatitjen e Dokumentacionit për Regjistrimin dhe Certifikimin e Tokave Bujqësore”, si dhe “Drejtoria e Turizmit dhe e Promovimit të Vlerave”, në Bashkinë Fier, ku në këtë të fundit siç u përmend më lart, ankuesi ***** ka qenë i punësuar në pozicionin “Specialist i Nivelit të Lartë”.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Ristrukturimit, ngritur me urdhrin nr. 631, datë 14.10.2021, të Kryetarit të Bashkisë Fier, bazuar në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me aktin nr. 9510/4 prot., datë 21.12.2021, “Njoftim për ristrukturim të institucionit Bashkia Fier, për shkak të ndryshimit të Strukturës Organizative, të Bashkisë Fier”, ka njoftuar nëpunësit e bashkisë në lidhje me këtë riorganizim, që është shoqëruar më shkurtimin e numrit të nëpunësve civilë në bashki në përgjithësi dhe në “Drejtorinë e Turizmit dhe e Promovimit të Vlerave”, në veçanti.

Mbi bazën e situatës së përshkruar më sipër Komisioni i Ristrukturimit, pasi ka vlerësuar të dhënat e dosjes së personelit të punonjësve, përvojën në punë, llojin dhe nivelin arsimor, kualifikimet e kryera, etj., ka vazhduar punën duke shqyrtuar mundësinë e sistemimit të tyre në ndonjë pozicion të përshtatshëm, sidomos të atyre nëpunësve të cilëve u është ristrukturuar apo shkurtuar pozicioni i punës, ku është përfshirë edhe rasti i nëpunësit ***** duke iu ofruar ndonjë nga pozicionet e mbetura apo krijuara në Bashkinë Fier.

Në përfundim të këtij procesi, për rastin e nëpunësit ***** Komisioni i Ristrukturimit, ka arritur në konkluzionin se kualifikimi i ankuesit (*mësuesi Histori-*

Gjeografi), nuk përputhet me objektivat apo detyrat e ndonjë prej pozicioneve të mbetura apo riorganizuara pas ristrukturimit, megjithatë për të lehtësuar sa më shumë situatën e krijuar, nëpunësit në fjalë i është propozuar të kalonte në pozicionin e punës *“Inspektor për promovimin e vlerave”*, në Drejtorinë e Artit, Kulturës dhe Promovimit të Vlerave në Bashkinë Fier.

Në përgjigje të këtij propozimi, nëpunësi në fjalë është paraqitur pranë Komisionit të Ristrukturimit, i cili i ka përsëritur propozimin për kalimin e tij në pozicionin e punës *“Inspektor për promovimin e vlerave”*, në Drejtorinë e Artit, Kulturës dhe Promovimit të Vlerave në Bashkinë Fier (sipas procesverbalit nr. 6212/2 prot., të mbajtur në datën 03.11.2021, të Komisionit të Ristrukturimit, në Bashkinë Fier).

Në lidhje me sa më sipër, punonjësi me deklarinimin e datës 04.11.2021, *“Përgjigje ndaj propozimit të paraqitur në takimin e datës 03.11.2021”*, drejtuar Komisionit të Ristrukturimit, ka sqaruar se, nuk e ka pranuar këtë pozicion pune, pasi ai nuk përfshihet në fushën e shërbimit civil.

Pasi e ka konstatuar të vërtetë sa më sipër, Komisioni i Ristrukturimit, mbështetur në nenin 66, pika 1, germa *“a”*, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ka arritur në përfundimin se kualifikimi i tij, nuk përputhet me kërkesat e veçanta të ndonjë prej pozicioneve të lira të shërbimit civil, të mbetura apo riorganizuara pas ristrukturimit, si dhe nga fakti që ankuesi nuk ka pranuar propozimin e bërë nga ky komision, për emërimin e tij në pozicionin *“Inspektor për promovimin e vlerave”*, në Drejtorinë e Artit, Kulturës dhe Promovimit të Vlerave në Bashkinë Fier, me vendimin nr. 9510/12 prot., datë 11.11.2021, ka vendosur të propozojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin civil, ***** , nga pozicioni punës *“Specialist i Nivelit të Lartë”*, në Drejtorinë e Turizmit dhe Promovimit të Vlerave, në Bashkinë Fier.

Vendimi përfundimtar është marrë nga njëسيا e burimeve njerëzore e cila, në bazë të propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, me aktin nr. 864, datë 11.11.2021, të Kryetarit të Bashkisë Fier, ka liruar nëpunësin nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit, duke vendosur edhe për shpërblimin përkatës, sipas pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar.

Në këtë rast, është me vend të përmendet edhe e drejta që i njeh nëpunësit ***** , pika 8, e nenit 50, të ligjit në fjalë, sipas së cilës nëpunësit civilë që janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e ristrukturimit, kanë të drejtë që brenda periudhës 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 e 26, të këtij ligji, etj.

Nga sa u parashtrua më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit të administruar arrihet në përfundimin se, veprimet e njësisë përgjegjëse dhe aktorëve të tjerë në këtë proces, janë kryer në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*.

Për këto arsye:

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, pika 2, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”* dhe neneve 16, pika 6 të Kreut III *“Procedura paraprake”*, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të kërkesës nr. 27, prot., datë 07.01.2022, të punonjësit *****; me objekt verifikimin e pretendimeve për parregullsi të kryera apo të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në lidhje me procedurën e lirimit nga detyra për shkak ristrukturimi *“Specialist i Nivelit të Lartë”*, në Drejtorinë e Turizmit dhe Promovimit të Vlerave, në Bashkinë Fier dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohen për këtë vendim, njësia përgjegjëse e Bashkisë Fier dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha